



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për Bëri, Kleda
dhe Anësi

Nr. 2911/Prot
2

Tiranë, më 18.07 2019

LËNDA: Dërgohet Projekt Raport Auditimi

AGJENCIA SHTETËRORE E TË DREJTAVE DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE

TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojme dy kopje të Projekt Raport Auditimit të ushtruar në institucionin tuaj, një kopje e të cilit duhet të dërgoni në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, të nënshkruar ose jo.

Në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhër nr. 100, datë 25.10.2016, kapitulli IV, "Kryerja e Auditimit të Brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit", brenda 10 ditëve pune, nese keni kundërshtime mund të paraqesni me shkrim shpjegime në lidhje me përmbajtjen e projekt raportit. Gjithashtu, brenda këtij afati, titullari i institucionit duhet të reagojë në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në Projekt Raport Auditimi, sipas afateve të përcaktuara.

Nga ana juaj, mund të kërkohet takim ballafaqes me grupin e auditimit, për të diskutuar lidhur me përmbajtjen dhe rekomandimet e lëna.

Me anë të kësaj shkrese jeni të lutur që një kopje e projekt raportit të auditimit të vihet në dispozicion të ish punonjësve, për t'u njohur me gjetjet dhe përgjegjësitë, sipas rastit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

Skënder Dreni



PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Për auditimin e kryer në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

I. Përmbledhje ekzekutive

Subjekt i vlerësimit është veprimtaria menaxhuese, arritjet e objektivave të institucionit dhe funksionimi i tij në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit periudhën Janar 2016 – Maj 2019.

Ky vlerësim u bazua në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, VKM nr. 346, datë 23.04.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, në planin vjetor për vitin 2019 të miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5345/1 prot, datë 12.10.2018 dhe Programit të Auditimit nr. 2911/1 prot, datë 07.06.2019.

Objektivat e vendosura nga grupi lidhur me këtë vlerësim janë:

- Auditimi i sistemit të prokurimeve, sistemit të pagesave, sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemit të kontabilitetit, sistemi i përputhshmërisë e zbatimit të buxhetit, sistemi i funksionimit dhe monitorimit të të drejtave dhe mbrojtjen e Fëmijëve nga muaji Janar 2016 deri në muajin Maj 2019, për të vlerësuar saktësinë e regjistrimeve financiare si dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetjet dhe konkluzionet

Pasqyra përmbledhëse.

Zbatimi i rekomandimeve	
❖	Janë lënë për zbatim 21 (Njëzet e një) rekomandime të karakterit organizativ, referencë Përfundimet e Angazhimit të Auditimit dërguar me shkresë nr. 1045/4 prot., datë 24.03.2016. Nga 21 rekomandime të lëna për zbatim janë zbatuar 14 prej tyre, 2 janë në proces zbatimi dhe 5 janë të pa zbatuara.
Pagesat	
❖	Kryetari i Agjencisë Shtetërore të të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve ka urdhëruar dërgimin me shërbim jashtë vendit të nëpunësve të institucionit pa marrë autorizimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, veprim i kryer në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendi”, pika 1, gërma “i”.
❖	Punonjësit kanë kryer lëvizje me shërbim taksii pa patur autorizim, apo një program pune të caktuar për të justifikuar qëllimin e lëvizjes me transport. Pagesa për lëvizjen me transport të nëpunësve nuk është kryer sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, Kreu III, pika 4. Shuma që do të kthehet në buxhetin e shtetit është 15,490 lekë.
❖	Janë kryer shpenzime të pa bazuar në dispozita ligjore për vitin 2018 me objekt “Takim pune me personelin, drekë në Durrës” për të përcaktuar objektivat e institucionit për vitin 2018 dhe për të kryer analizën vjetore të punës për vitin 2017. Shuma prej 38,100 lekë do të arkëtohet në buxhetin e shtetit nga personat përgjegjës të cituar në mënyrë analitike.

Kontabiliteti

- ❖ Të dhënat në ditarin e shpenzimeve nuk janë regjistruar në nivel 7- shifror sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, njëkohësisht dhe llogari e planit kontabël publik. Këto të dhëna janë regjistruar në nivel 3-shifror në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafi "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike", pika 155, shfuqizuar me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 12.
- ❖ Për vitin 2016, 2017 dhe 2018 fletët e inventarizimit të aktiveve nuk ishin firmosur nga komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit por ishin të firmosura vetëm nga kryetari i komisionit në cilësinë e specialistes së Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë). Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, i ndryshuar pika 85.

Të tjera të konstatuara gjatë punës në terren

- ❖ Institucioni nuk kishte hartuar regjistrin e riskut për të parandaluar riskun që mund të çënojë arritjen e objektivave të institucionit.

Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Referuar gjetjeve të konstatuara vlerësojmë se stafi i ngarkuar me detyra që lidhen me prokurimet, menaxhimin e aktiveve dhe mbikqyrjen e kontratave ka qenë në nivelin e duhur për njohjen e akteve që operojnë në këto fusha. Nuk ka neglizhenca të treguara në përmbushjen e detyrave nga grupet e punës për fushën e prokurimeve, në mënyrën e zbatimit të buxhetit dhe hartimin e pasqyrave financiare për kontabilitetin.

Nivelet e menaxhimit duhet të forcojnë qëndrimin e tyre mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm duke rritur kërkesën e llogarisë për çdo problematikë që mund të haset gjatë punës, kryesisht në sistemin e pagesave ku u konstatuan likuidime për shpenzime të cilat nuk kanë bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e duhur vërtetues.

Institucioni nuk ka hartuar regjistrin e riskut, komponent shumë i rëndësishëm në identifikimin e risqeve dhe marrjen e masave të duhura për strukturat përgjegjëse.

Grupet e punës të ngritura për përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike apo dhe njësia e prokurimit kanë dhënë siguri në përmbushje të akteve ligjore që operojnë në fushën e prokurimeve, duke shmangur në punën e tyre evidentimin në dokumentacionin e mbajtur të argumenteve dhe analizave si nga ana teknike ashtu dhe ligjore.

Si përfundim, vlerësojmë se ka munguar monitorimi sipas hierarkisë, nga menaxheret e nivelit më të ulët përgjegjës sektori e deri te menaxherët e nivelit më të lartë drejtor në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore për organizimet e aktiviteteve social kulturor dhe pagesat për shpenzime transporti për lëvizje brenda vendit.

Rekomandimet;

Bazuar në gjetjet e konstatimet e trajtuara, në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në të ardhmen, janë adresuar rekomandimet e mëposhtme (**kryesoret**):

1. Rekomandojmë të hartohet regjistri kontabël, i aktiveve si dhe të bëhet regjistrimi i të gjitha ngjarjeve ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare në përputhje me aktet

- ligjore e nënligjore në fuqi. Nga Nëpunësi Zbatues të ushtrohen kontrollet e brendshme të domosdoshme për mirëfunksionimin e sistemit kontabël e financiar.
- II. Nëpunësi Autorizues i këtij institucioni të nxjerrë urdhër të brendshëm për të ngarkuar një specialist me detyrën e magazinës krahas detyrave që ka të përshkruar në rregulloren e punës bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 15.
 - III. Specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) të hartojë gjurmën e auditit për vlerën 454.298 lekë. lëvizje brenda sistemit në llogarin 218 të evidentuar si shtesë dhe e paraqitur në bilancin e vitit 2017.
 - IV. Specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) brenda muajt Korrik të vitit 2019 të plotësoje dokumentacionin vërtetues shoqërues mbi lëvizjen e aktivitetit (kondicioner) si pakësim paraqitur në llogarin 214 të bilancit për vitin 2017, procedura bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, në të kundërt vlera 99.600 lekë të derdhet në buxhetin e shtetit.
 - V. Komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit për inventarizimin e aseteve të institucionit, të kryejë me përgjegjësi ligjore të gjithë procedurën për inventarizimin, sipas urdhrave të titullarit të njësisë për të vërtetuar saktësinë dhe cilesinë e gjendjes fizike të aktiveve.
 - VI. Të hartohet regjistri i riskut i institucionit i cili duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 - VII. Për çdo shërbim jashtë vendit të merret autorizim i titullarit të institucionit qendror nga i cili varet njësia shpenzuese, ose të deleguarit të tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
 - VIII. Elona Halilosmani të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën **340** lekë të përfutur për shërbimin Taksi, për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
 - IX. Ina Verzivolli të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën **14,080** lekë të përfutur për shërbimin Taksi, për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
 - X. Anila Bregu të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën **1,070** lekë të përfutur për shërbimin Taksi, për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
 - XI. Titullari i institucionit përgjegjës për vitin 2017 (znj. Ina Verzivolli), e cili ka nxjerrë urdhër të brendshëm për organizimin e takimit të punës në Durrës (drekë pune) në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sëbashku me pjesëmarrësit në drekën e organizuar, do të kthejnë në buxhetin e shtetit, në përpjestim të drejtë me numrin e pjesëmarrësve, shumën prej **38,100** lekë.

II. Hyrje.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë zbaton politikat sociale, për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet strukturave të përfshira në to dhe të miratuara nga MSHMS. Institucioni ka hartuar rregulloren e brendshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 23.04.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve".

Financimi i ASHDMF Tiranë sigurohet nëpërmjet buxhetit të shtetit si dhe nga fonde të donatorëve të ndryshëm vendas apo ndërkombëtarë për të përmbushur detyrimet dhe funksionet e saj.

Struktura analitike është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 807/2, datë 16.02.2018, me numër total prej 7 punonjës

Programi i Auditimit u miratua nga Drejtori i Auditit të Brendshëm në MSHMS me shkresë nr. 1182/2 prot., datë 27.03.2019.

Periudha e auditimit:	01 Janar 2016 deri më 31 Maj 2019
Afati i auditimit:	07.06.2019 – 28.06.2019.
Grupi i auditimit:	Jorgji Qeramixhi Zogulla Koto
Qëllimi i auditimit:	Të vlerësojë e të identifikojë nëse ka mangësi në funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në ASHDMF Tiranë, dhe të japë rekomandime për të përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
Takimi prezantues:	Datë 07.06.2019.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga auditimi, hartohet ky Projekt Raport Auditimi, i cili i vihet në dispozicion të Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë.

III. Metoda e Auditimit.

Referuar subjektit të vlerësimit lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm për sistemin e prokurimeve, sistemin e pagesave, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare si dhe sistemin e funksionimit dhe monitorimit të të drejtave dhe mbrojtjes të fëmijëve u përcaktua lloji i auditimit: "Auditim mbi bazë sistemi".

Metodat e auditimit u përzgjedhën bazuar në llojin e auditimit dhe janë si më poshtë:

- Testimi hap pas hapi
- Rindërtimi i ngjarjeve
- Inspektimi fizik

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Pas auditimit të të gjithë sistemeve të përcaktuara në programin e auditimit, grupi i auditimit jep vlerësimet e mëposhtme:

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit

Auditimi i fundit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë është kryer në zbatim të programit të miratuar me shkresë nr. 2911/I prot, datë 07.06.2019.

Në përfundim janë lënë për zbatim 21 (Njëzet e një) rekomandime të karakterit organizativ; referencë Përfundimet e Angazhimit të Auditimit dërguar me shkresë nr. 1045/4 prot., datë 24.03.2016.

Nga 21 rekomandime të lëna nga auditimi për zbatim u konstatua se janë zbatuar 14 (katërbëdhjetë) prej tyre, 4 (katër) nuk janë zbatuar dhe 3 (tre) janë në proces zbatimi.

Nga auditimi rezultoi si më poshtë:

Rek.Nr.1: "Të vazhdohet bashkëpunimi me strukturat e qeverisjes vendore, të rishikohet funksionimi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivelin vendor me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimit të ofruar nga kjo njësi". – **Në proces zbatimi.**

Rek.Nr.2: "Të bashkëpunohet me të gjithë institucionet qendrore dhe vendore për të menaxhuar dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit në ndihmë të fëmijëve në rrezik". – **Në proces zbatimi.**

Rek.Nr.3: "Të rritet bashkëpunimi me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës për rritjen e të ardhurave, sponsorizimeve dhe përdorimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve". – **Në proces zbatimi.**

Rek.Nr.4: "Të plotësohet struktura analitike e agjencisë për të përmbushur detyrimet sipas Ligjit dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". – **I pa zbatuar.**

MSHMS ka dërguar strukturë të re për institucionin por kjo strukturë përsëri nuk plotëson kërkesat për përmbushjen e detyrimeve të Ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rek.Nr.7: "Të hartohen gjurmët e auditit dhe lista e proceseve të punës për udhëtimet e shërbimit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në zbatim të nenit 12, pika 3, gërma "dh" të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". – **I pa zbatuar.**

Rek.Nr.11: "Të hartohen gjurmët e auditit për prokurimet publike, të paraqiten për miratim tek titullori i institucionit. Sipas gjurmës të përcaktohen rregulla të qarta për strukturën/personin përgjegjës që përfshin të gjitha etapat nga parashikimi i fondeve, inventarizimi i dosjes së prokurimit deri në likuidimin e vlerave të prokuruar". – **I pa zbatuar.**

Rek.Nr.19: "Të përcaktohen rregulla për arkivimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të arkivës, në zbatim të nenit 183 të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor R.SH të DP të arkivave". – **I pa zbatuar.**

IV.1. Sistemi për prokurimet

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse parashikimi, realizimi i prokurimeve dhe raportimi janë në përputhje me legjislationin në fuqi për prokurimet.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

Hartimi i regjistrit të parashikimit dhe raportimi i realizimit të tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi për prokurimet,

Zbatimimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2016, 2017, 2018, 2019 janë raportuar në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Organin Qendror në përputhje me afatet e parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi për prokurimet publike.

Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik, për periudhën e audituar, u përzgjedhën për auditim 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël:

1. "Blerje Bluza për vitin 2017" të realizuar në shumën 48,000 lekë.
2. "Kancelari, viti 2017" të realizuar në shumën 118,990 lekë.
3. "Banera, viti 2016" realizuar në shumën 46,192 lekë.
4. "Material zyre, viti 2016" realizuar në shumën 15,500 lekë.
5. "Kancelari, viti 2016" realizuar në shumën 83,425 lekë.
6. "Materiale zyre, viti 2018" realizuar në shumën 107,900 lekë.
7. "Kancelari, viti 2018" realizuar në shumën 107,870 lekë.
8. "Shërbim kondicioneri, 2018" realizuar në shumën 19,200 lekë.
9. "Dreke pune, viti 2018" realizuar në shumën 38,100 lekë.
10. "Kancelari, viti 2019" të realizuar në shumën 106,613 lekë.
11. "Materiale pastrimi, 2019" të realizuar në shumën 83,988 lekë.
12. "Bojra printeri, viti 2019" të realizuar në shumën 104,400 lekë.

Sa më sipër nga auditimi i sistemit të prokurimeve me vlerë të vogël rezultoi se janë zbatuar të gjithë procedurat përkatëse të prokurimit duke filluar nga regjistrat e parashikimit dhe realizmit të prokurimeve publike, kërkesat e sektorëve për blerjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve/punëve, ngritjen e komisioneve të prokurimit me vlerë të vogël si dhe komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, nxjerrjen e urdhër prokurimit, plotësimi i formularëve standart të prokurimit, nënshkrimi i deklaratave të konfliktit të interesit, shpallje e ftesës për oferte si dhe shpallja e fituesit me vlerën më të vogël.

Për këtë sistem nuk ka gjetje dhe kjo tregon se kanë funksionuar kontrollet e brendshme për arritjen e objektivave të institucionit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

IV.2. Sistemi për pagesat

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse pagesat janë kryer konform Ligjit për buxhetin dhe udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Financës për zbatimin e procedurave të zbatimit të buxhetit.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

Kryerja e pagesave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, verifikimi i dokumentacionit justifikues.

Regjistrimi i transaksioneve të kryera në ditarin e bankës për emërtesën, vlerën dhe llogarinë kontabël.

Respektimi i destinacionit të fondeve buxhetore të alokuara me regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe manualin për klasifikimin buxhetor ekonomik.

Për sistemin e pagesave u përzgjedhën për auditim lidhjet e bankës për vitin 2016 (Muaji Prill, Korrik, Tetor), vitin 2017 (Muaji Mars, Prill, Maj), viti 2018 (Muaji Maj, Korrik, Gusht) si dhe për vitin 2019 është audituar Muaji Prill.

Nga auditimi rezultoi si më poshtë:

Nëpunësit e Agjencisë Shtetërore të të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve kanë kryer shërbime jashtë vendit për konventa/konferenca/takime biletarela duke përfaqësuar Agjencinë në mardhëniet me Autoritetet e Huaja përgjegjëse për këtë fushë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kryetari i ASHDMF Tiranë ka autorizuar lëvizjen e nëpunësve të institucionit jashtë vëndit sipas thirrjeve apo axhendes të dërguar nga Autoritetet e Huaja. Shpenzimet e dietave janë paguar nga vetë institucioni sipas tarifave dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Problem i konstatuar në pagesën e dietave është që Autorizimi për lëvizjen e Nëpunësve të ASHDMF Tiranë duhet të kryhet nga titullari i njësisë publike (Ministri) dhe jo nga Kryetari i ASHDMF i cili në rastet konkrete ka marrë përgjegjësinë e titullarit të njësisë publike në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjetje:

- ❖ Kryetari i Agjencisë Shtetërore të të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve ka urdhëruar dërgimin me shërbim jashtë vëndit të nëpunësve të institucionit pa marrë autorizimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, veprim i kryer në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vëndi", pika 1, gërma "i" ku citon se: *Dërgimi me shërbim jashtë vëndit bëhet me urdhër të titullarit të institucionit qendror nga i cili varet njësia shpenzuese, ose të deleguarit të tij. Për këtë veprim të kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ngarkohet me përgjegjësi ish titullari për periudhën përkatëse dhe titullarin aktual.*

Për vitin 2017 janë kryer pagesa për shërbim taksi brenda Tiranës'

- ❖ Punonjësit kanë kryer lëvizje me shërbim taksi pa patur autorizim, apo një program pune të caktuar për të justifikuar qëllimin e lëvizjes me transport. Pagesa për lëvizjen me transport të nëpunësve nuk është kryer sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vëndit" i ndryshuar, Kreu III, pika 4 ku thekson se: *në çdo rast, kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shpenzimet e transportit do të njihen kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, e miratuar me VKM nr. 146, datë 26.2.1998 "Për tarifat e transportit të udhëtarëve".* Në gjetjet e konstatuara titullari dhe nëpunësit e institucionit kanë kryer lëvizje me taksi brenda Qytetit të Tiranës, pagesat e transportit janë kryer kundrejt tarifave të përcaktuara nga operatorët privatë në treg të shoqëruar me kuponin tatimor dhe jo kundrejt tarifave të përcaktuara në vendimet e këshillit të ministrave. Gjithashtu çdo lëvizje e kryer nuk është pasqyruar në urdhër shërbimet përkatëse. Pagesat janë kryer nëpërmjet urdhër shpenzimeve në të cilën ka qene bashkangjitur vetëm kuponi tatimor dhe asnjë dokument tjetër justifikues.

Personat që do të kthejnë lekët në buxhetin e shtetit për përfitim pagese për shpenzime transporti në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vëndit" i ndryshuar, Kreu III, pika 4 paraqiten si më poshtë:

- ❖ Elona Halilosmani ka përfituar shumën 340 lekë për shërbimin Taksi që ka marrë për lëvizje brenda Tiranës. Pagesa është kryer sipas kuponit tatimor të lëshuar nga subjekti privat "Merr Taxi" shpk. Nuk ka asnjë informacion, autorizim apo të dhënë për të përcaktuar qëllimin e lëvizjes. Pagesa është kryer vetëm nëpërmjet dokumentacionit të vetëm justifikues që është kuponi tatimor. Shuma **340 lekë** do të arkëtohet në buxhetin e shtetit nga znj. Elona Halilosmani.
- ❖ Ina Verzivollli ka përfituar shumën 12,230 lekë për shërbimin Taksi që ka marrë për lëvizje brenda Tiranës. Pagesa është kryer sipas kuponit tatimor të lëshuar nga subjekti privat "Merr Taxi" shpk. Nuk ka asnjë informacion, autorizim apo të dhënë për të përcaktuar qëllimin e

lëvizjes. Paguesa është kryer vetëm nëpërmjet dokumentacionit të vetëm justifikues që është kuponit tatimor. Shuma **12,230 lekë** do të arkëtohet në buxhetin e shtetit nga znj. Ina Verzivolli, ish titullar i institucionit.

Për vitin 2016 janë kryer pagesa për shërbim taksi brenda Tiranës si më poshtë:

- ❖ Ina Verzivolli ka përfituar shumën 1,850 lekë për shërbimin Taksi që ka marrë për lëvizje brenda Tiranës. Paguesa është kryer sipas kuponit tatimor të lëshuar nga subjekti privat "Merr Taxi" shpk. Nuk ka asnjë informacion, autorizim apo të dhënë për të përcaktuar qëllimin e lëvizjes. Paguesa është kryer vetëm nëpërmjet dokumentacionit të vetëm justifikues që është kuponit tatimor. Shuma **1,850 lekë** do të arkëtohet në buxhetin e shtetit nga znj. Ina Verzivolli, ish titullar i institucionit.
- ❖ Anila Bregu ka përfituar shumën 1,070 lekë për shërbimin Taksi që ka marrë për lëvizje brenda Tiranës. Paguesa është kryer sipas kuponit tatimor të lëshuar nga subjekti privat "Merr Taxi" shpk. Nuk ka asnjë informacion, autorizim apo të dhënë për të përcaktuar qëllimin e lëvizjes. Paguesa është kryer vetëm nëpërmjet dokumentacionit të vetëm justifikues që është kuponit tatimor. Shuma **1,070 lekë** do të arkëtohet në buxhetin e shtetit nga znj. Anila Bregu.

Për vitin 2017 është kryer shpenzim me objekt "Organizim i një takim pune në qytetin e Durrësit" në shumën 38,100 lekë të likuiduar me Urdhër Shpenzim nr. 8, datë 6.2.2018. Shpenzimi kishte për qëllim organizimin e një drekë me pjesëmarrjen e stafit të Agjencisë së të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Tiranë për diskutimin e analizës vjetore të këtij institucioni dhe përcaktimin e objektivave në planet e punës për vitin 2019. Dreka është organizuar tek Operatori Ekonomik "GIOD" Shpk në qytetin e Durrësit ku kanë qene pjesëmarrës 11 punonjësit e ASHDMF Tiranë.

Gjetje:

Shpenzimet e kryera për organizimin e drekës nuk justifikojnë qëllimin për të cilën ky institucion ka të parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi. Analiza vjetore dhe objektivat që përcaktohen për vitet në vijim, të parashikuar në rregulloren e brendshme të institucionit, kryhen në përputhje me funksionalitetin e vet në ambientet e institucioni pa kosto shtesë, si në rastin konkret, të cilat nuk janë të parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar, pika 2/e, si dhe pika 8 theksojnë se: *Veprimtaritë e ndryshme që kanë karakter social apo kulturor, sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit, dhe të tjerë organizime të realizuara nga institucioni, përballohen nga fondi i veçantë. Në këto veprimtari social-kulturore, kur ato organizohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet e transportit dhe akomodimit paguhen nga vetë punonjësit.*

Në rastin e përdorimit, fondi i veçantë transferohet nga vetë Njësia nga artikulli 600 tek artikulli 602.9002 "Shpenzime për aktivitetet sociale për personelin" sipas natyrës së shpenzimit. Në rastet e organizimit të aktiviteteve social kulturore, Njësia Shpenzuese duhet ti paraqitë kërkesë Organit Qendror për aktivitetin që do të kryejë, dhe më pas Organi Qendror e dërgon tek Nëpunësi i Parë Autorizues (Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë) i cili shqyrton nëpërmjet strukturës përgjegjëse të buxhetit dhe i propozon për miratim Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Kjo kërkesë duhet të përmbajë një informacion lidhur me shumën që do përdoret nga fondi i veçantë.

Institucioni duhet të kishte kishte bërë kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e përdorimit të fondit të veçantë për kryerjen e aktiviteteve sociale kulturore në përputhje me Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 403/1 prot, datë 13.1.2017 për dërgimin e udhëzimit plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pika 31.32.33.34.

Si përfundim, Shpenzimet e kryera për drekën e organizuar në Durrës me personelin e ASHDMF Tiranë për takim pune për analizën vjetore të vitit 2017 dhe për përcaktimin e objektivave të institucionit për vitin 2018 është në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, pika 2/e, si dhe pika 8 dhe në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 403/1 prot, datë 13.1.2017 për dërgimin e udhëzimit plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pika 31.32.33.34, pasi ky shpenzim nuk është një aktivitet social kulturor por një takim pune që veprimtarinë e vet funksionale duhet ta ushtrojë në përputhje me kompetencat e parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Titullari i institucionit përgjegjës për vitin 2017 (znj. Ina Verzivolli), e cili ka nxjerrë urdhër të brendshëm për organizimin e takimit të punës në Durrës, sëbashku me pjesëmarrësit në drekën e organizuar, do të kthejnë në buxhetin e shtetit, në përpjestim të drejtë me numrin e pjesëmarrësve, shumën prej 38,100 lekë.

Si përfundim, referuar gjetjeve të konstatuara për pagesat u konstatua mungesë e kontrolleve në procese, si likuidimi i faturave tatimore pa patur dokumentacione vërtetues bashkangjitur. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për pagesat tregon se aktivitetet e kontrollit nuk kanë funksionuar siç duhet. Gjithashtu dhe monitorimi nuk ka qenë në nivelin e duhur duke filluar që nga monitorimi i punës nga vetë punonjësi dhe deri tek monitorimi në nivel menaxhues.

IV.3.Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse burimet njerëzore menaxhohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me strukturën organizative të miratuar.

Fushat që do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

Pershkrimi i vendit të punës dhe vlerësimi i punonjësve.

Vlerësimi i performancës së punonjësve.

Përlllogaritja e pagës bruto deri tek paga neto në përputhje me emërtesën në strukturë dhe me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Për respektimin e numrit të punonjësve, ky institucion për periudhën 01 Janar 2016 – 16 Shkurt 2018 operon me strukturën analitike të vitit 2012 të miratuar nga Kryeministri me Urdhërin nr. 148, datë 24.12.2012, me numër total prej 7 punonjës, kurse për vitin 2018 e në vazhdim bazuar në strukturën e dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 807/2, datë 16.02.2018, me numër total prej 7 punonjës.

Për verifikimin e respektimit të numrit të punonjësve sipas strukturës së miratuar, rezultoi se është respektuar struktura analitike për numrin total të punonjësve, sipas sektoreve.

a.Pershkrimi i vendit të punës dhe vlerësimi i punonjësve.

Pershkrimet e punës ishin hartuar për çdo pozicion sipas strukturës analitike të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar gjetjeve të konstatuara vlerësojmë se stafi i ngarkuar me detyra që lidhen me prokurimet, menaxhimin e aktiveve dhe mbikqyrjen e kontratave ka qenë në nivelin e duhur për njohjen e akteve që operojnë në këto fusha. Pavarësisht se këto duken si procese rutinë vërehet se kanë nxitur nivelet menaxhuese në drejtim të kërkesës së llogarisë në përmbushje të detyrave në përputhje me aktet ligjore. Nuk ka neglizhenca që tregojnë mospërmbushje të detyrave nga grupet e punës për fushën e prokurimeve, burimeve njerëzore dhe pagat.

Nivelet e menaxhimit duhet të forcojnë qëndrimin e tyre mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm duke rritur kërkesën e llogarisë dhe të mbështesë grupet e punës për çdo problematikë që mund të haset gjatë punës.

Menaxhimi i riskut- ASHDMF Tiranë nuk ka hartuar regjistrin e riskut. Ky komponent është mjaft i rëndësishëm pasi bazuar në objektivat e vendosura, institucioni do të vlerësojë risqet e mundshme si dhe do të propozojë marrjen e masave të duhura për strukturat përgjegjëse.

Për këtë rekomandohet të bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin e regjistrit të riskut në mënyrë të tillë që ky dokument të përmbajë të gjithë komponentët e tij.

Gjithashtu ky regjistër duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Aktivitetet e kontrollit- Nga ana e titullarit të institucionit për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë ngritur grupe pune për mbikqyrje dhe zbatimin e kontratës. Kontrollat e ngritura kanë funksionuar siç duhet pasi në përmbushje të detyrave të caktuara kanë vepruar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Grupet e punës të ngritura për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike apo dhe njësia e prokurimit kanë dhënë siguri në përmbushje të akteve ligjore që operojnë në fushën e prokurimeve, duke shmangur në punën e tyre evidentimin në dokumentacionin e mbajtur të argumenteve dhe analizave si nga ana teknike ashtu dhe ligjore.

Kontrollet menaxhuese nuk kanë qenë në nivelin e duhur për shtimin e kontabilitetit dhe shpenzimet e transportit për lëvizjet brenda vendit punonjësit e institucionit nuk kanë patur njohuri të thelluara për bazën ligjore që operon në këto fusha.

Informacioni dhe komunikimi- Ky komponent nuk është kuptuar si shkëmbim i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjithë niveleve si horizontalisht dhe vertikalisht. Informacioni nuk ka shërbyer në mbështetje të funksionimit të kontrolleve të brendshme, kjo është reflektuar në mungesën e këtyre kontrolleve.

Monitorimi- Nisur nga gjetjet e konstatuara nga auditimit, vlerësojmë se ka munguar monitorimi sipas hierarkisë, nga menaxheret e nivelit më të ulët përgjegjës sektori e deri te menaxherët e nivelit më të lartë drejtor ekzekutiv (kryetari).

Mungesa e monitorimit të aktiviteteve nuk ka garantuar se punonjësit i zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet dhe aktivitetet e kontrollit po funksionojnë siç duhet për kontabilitetin dhe pagesat.

V. Rekomandimet.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në gërmen "c" të nenit 6, dhe gërmen "e" të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", për arritjen e objektivave të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat

në vazhdim) si dhe specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë).

Çdo menaxher është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keq përdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre. Pra në këtë regjistër duhet të ishin përfshirë si aktivet afatgjata ashtu edhe afatshkurtëra materiale, ku të shënoheshin data e hyrjes së aktivit ose e marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen e vlerës së aktivit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të aktivit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shërbimeve të mirëmbajtjes si dhe datën e daljes nga pronësia. Hartimi i këtij regjistri i shton vlerën institucionit në menyrë të tillë që të rezultojë në mënyrë kronologjike një historik i aktivit dhe një identifikim i saktë i tyre.

Si perfundim, rekomandojme të hartohet regjistri kontabël, i aktiveve si dhe të bëhet regjistrimi i të gjitha ngjarjeve ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga Nëpunësi Zbatues të ushtrohen kontrollet e brendshme të domosdoshme për mirëfunksionimin e sistemit kontabël e financiar.

b. Mbajtja e regjistrimi i dokumentave financiare në librat e kontabilitetit, ditar bankë, arke dhe magazine.

Nga auditimi rezultoi se mbajtja e kontabilitetit dhe regjistrimi i veprimeve financiare është kryer në përputhje me Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Veprimet financiare janë regjistruar në ditaret përkatës.

Urdhër shpenzimet janë regjistruar në ditarin kontabël të pagesave, pjesë e së cilës është dhe ditari i shpenzimeve. Në këtë ditar të dhënat janë regjistruar në llogarinë ekonomike 600 “Pagë, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli”, llogarinë 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, llogarinë 602 “Mallra e shërbime të tjera”, dhe llogarinë 23 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme”.

Gjetje:

Të dhënat në ditarin e shpenzimeve nuk janë regjistruar në nivel 7- shifror sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, njëkohësisht dhe llogari e planit kontabël publik. Këto të dhëna janë regjistruar në nivel 3-shifror.

Nga specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës për periudhën objekt auditimi është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika 155, shfuqizuar me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 12.

Gjithashtu gjatë auditimit u konstatua se urdhër shpenzimet ishin regjistruar në ditarë pa datë dhe pa objektin e shpenzimit, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30. Për sa më sipër për këtë veprim mban përgjegjësi specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (i ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë).

Gjatë auditimit u konstatua se Fletë-Hyrjet dhe Fletë-Daljet firmoseshin nga Nëpunësi i ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika 15.

Si përfundim, rekomandojmë që Nëpunesi Autorizues i këtij Institucioni të nxjerrë urdher të brendshëm për të ngarkuar një specialist me detyrën e magazinës krahas detyrave që ka të përshkruar në rregulloren e punës bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 15.

c. Pasqyrimi në bilanc sipas llogarive përkatëse të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Për dokumentimin, regjistrimin kontabël, mbrojtjen, dhe qarkullimin e këtyre aktiveve u përzgjedhen investimet e realizuara, llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione", llogaria 214 Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", llogaria 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventari ekonomik" llogari këto të cilat janë pasqyruar në bilancin e cdo viti si më poshtë:

Të dhëna mbi AAM (Aktivet afat gjata materiale) viti 2016, 2017 dhe 2018

Nr. llog	Vlera bilancit 31.12.2015	Shtesa pa pages	Vlera bilancit 31.12.2016	Levizje brenda aktiveve	Pakesi me	Vlera bilancit 31.12.2017	Vlera bilancit 31.12.2018
212	0	0	0	0	0	0	0
214	166.230	0	166.230	0	99.600	66.630	86.619
215	0	3.749.520	3.749.520	0	0	3.749.520	1.986.278
218	1.843.204	0	1.843.204	454.298	0	2.297.502	1.061.354
	1.859.434	3.749.520	5.608.954	454.298	99.600	6.131.641	3.134.251

Para mbylljes së bilancit, shumat e llogarive përkatëse janë hedhur në centralizator sipas rastit në debi apo kredi të tij. Nga shqyrtimi i bilancit rezulton se veprimet arithmetike janë kryer në rregull, veprimet në të janë të kuadrura dhe shumat e aktivitetit ishte e barabartë me shumën e pasivit.

Për vitin 2016 vlera në llog. 215 "Mjete transporti" përfaqëson kalim kapitali pa pagesë të automjetit tip Mitsubishi Pajero me targë TR3271F nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Nga verifikimi fizik i llogarisë 215 "Mjete transporti" rezultoi se ky institucion kishte në inventarin e tij automjetin tip Mitsubishi Pajero me targë TR3271F.

Siç konstatohet dhe nga tabela e pasqyrave financiare (bilanci) për vitin 2017, te kolona lëvizje brenda aktiveve në llogarin 218 është shtuar vlera 454.298 lekë.

Gjetje:

Gjatë auditimit u konstatua se tek pasqyrat financiare (bilanci) i vitit 2017, Formati nr. 6 gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) në kolonen lëvizje brenda aktiveve është pasqyruar shtesa gjatë vitit ushtrimor në vlerë 454.298 lekë. Kjo lëvizje nuk është sqaruar dhe në relacionin bashkangjitur këtij bilanci dhe gjithashtu nga specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) nuk u dha asnjë shpjegim për faktin se çfarë përfaqëson vlera e mësipërme e pasqyruar si lëvizje e brendshme.

Si përfundim, rekomandojmë që nga specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) të hartohet gjurma e auditit për vlerën 454.298, levizje brenda sistemit në llogarinë 218 evidentuar si shtesë e paraqitur në bilancin e vitit 2017.

Gjithashtu gjatë auditimit u konstatua se tek pasqyrat financiare (bilanc) i vitit 2017, Formati nr. 6 gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) te kolona lëvizje brenda aktiveve janë pasqyruar pakësime në vlerën 99.600 lekë. Nga komunikimi verbal që u bë me specialisten e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiare të njësisë) u theksua se kjo vlerë përfaqëson heqjen nga inventari të një kondicioneri i cili është lënë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pas largimit nga zyrat e kësaj Ministrie. Por ky veprim nuk është dokumentuar me fletë dalje përkatëse.

Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, dokumenti i levizjes së aktiveve, pika 35, shkronja "b" dhe pika 36.

***Si përfundim,** rekomandojmë që nga specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiare të njësisë) brenda muajit Korrik të vitit 2019 të plotësojë dokumentacionin vërtetues mbi lëvizjen e aktivitet (kondicioner) si pakësim paraqitur në llogarinë 214 të bilancit të vitit 2017, procedura bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, në të kundërt vlera 99.600 lekë të derdhet në buxhetin e shtetit.*

ç. Pasqyrimi i inventareve të aktiveve dhe rakordimi midis inventarizimit fizik dhe gjendjes kontable të këtyre aktiveve

Nga drejtoria e këtij institucioni në fund të vitit 2016, 2017 dhe 2018 ishin ngritur komisionet për evidentimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra.

Për vitin 2016 nga drejtoria e këtij institucioni është nxjerë urdhër i brendshëm nr. 113, datë 28.12.2016 për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë.

Për vitin 2017 është nxjerë urdhër i brendshëm nr. 218, datë 28.12.2017 për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë.

Për vitin 2018 është nxjerë urdhër i brendshëm nr. 214/1, datë 28.12.2018 për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë.

Komisioni ishte ngritur me tre antare duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar.

Shuma e vlerës faktike të gjithë fleteve të inventareve është e barabartë me shumën e llogarive përkatëse në bilanc, pra vlera kontable përputhej me vlerën fizike të tyre.

Gjetje:

Pavarësisht se nga drejtuesi i institucionit ishin ngritur komisionet e inventarizimit të aktiveve, nga auditimi në këtë fushë u konstatua se për vitin 2016, 2017 dhe 2018 fletët e inventarizimit të aktiveve nuk ishin firmosur nga komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit por ishin të firmosura vetëm nga kryetari i komisionit në cilësinë e specialistes së Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiare të njësisë). Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 85.

***Si përfundim,** rekomandojmë që komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit për inventarizimin e asetëve të institucionit të kryejë me përgjegjësi ligjore të gjithë procedurën për inventarizimin sipas urdhrave të titullarit të njësisë për të vërtetuar saktësinë dhe cilësinë e gjendjes fizike*

d. Procedura e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

Për periudhën e audituar nuk kishte dalje jashtë përdorimi të aktiveve.

dh. Përllogaritja e normës së amortizimit sipas llogarive përkatëse të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

Për vitin 2018 u përzgjedhen për auditim përllogaritja e normës së amortizimit e cila ishte kryer sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se sistemi i kontabilitetit ka funksionuar në drejtim të kontrollit të brendshëm si në mjedisin e kontrollit dhe aktivitetet e kontrollit me përjashtim të rasteve të trajtuara më sipër që lidhen me regjistrin kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim i cili duhet të përfshijë si aktivet afat gjata ashtu dhe aktivet afat shkurtra.

Gjithashtu komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit për inventarizimin e aseteve të institucionit të kryejë me përgjegjësi inventarizimin sipas urdhrave të titullarit të njësisë dhe ta dokumentojë atë me procesverbal të rregullt të firmosur nga të gjithë anëtarët e tij.

IV.4.Përputhshmeria e zbatimit të buxhetit.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse buxheti është menaxhuar në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe në mënyrë efektive e efçente.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura.

Klasifikimi i tyre sipas standarteve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo kategori.

Evidentimi dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhërat e gjykatës apo zyrave të përmbartimit gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të formës prerë, të mbetura të papaguara 30 ditë pas datës së përcaktuar në kontrat apo ligj.

Verifikimi i regjistrit të prokurimeve për fondet publike, mallra shërbime, punë publike të depozituar pranë Degës së Thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimor.

Auditimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme, të investimeve, apo shërbimeve në vitin ushtrimor dhe atyre që zgjasin në vitet në vazhdim, përpara se të fillojë procedura e prokurimit publik.

Auditimi i regjistrimit, evidentimit në kontabilitet, si dhe Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) të Degës së Thesarit të detyrimeve të prapambetura dhe të shtesave të kontratave. Verifikimi i dokumentacionit mbështetës dhe procedurave për përfshirjen e detyrimeve financiare në listën e shlyerjes së tyre.

Verifikimi i respektimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për secilin kategori, sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimit financiar dhe sipas sektorëve.

Për këtë fushë auditimi u krye lidhur me evidentimin e saktë të të drejtave dhe detyrimeve në llogaritë e klasës 4 (Kërkesa arketimi mbi debitoret ose kreditorët).

Për auditimin e pasqyrave financiare u përzgjedhën bilancet e viteve 2016, 2017 dhe 2018. Në këto bilance ishin pasqyruar të drejtat dhe detyrimet sipas llogarive përkatëse të cilat konkretisht paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Emeritimi i llogarisë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Llog.401-408 furnitor	0	0	0
Llog.421 Pers.e llog.te lidhura me to	542.141	452.504	463.611
Llog.431 Detyrim ndaj shtetit tatim-taksa	47.113	46.851	45.800
Llog.435 Sigurime Shoqërore	159.788	152.041	141.296
Llog.436 Sigurime Shëndetësore	22.521	21.434	21.434
Llog.467 Kred. të ndryshëm	0	0	0

Në pasiv të bilancit në llogaritë e klasës 4 siç shihet dhe nga tabela (llog 401-408) gjendja është zero për arsye se institucioni nuk ka detyrime ndaj OSHEE dhe Ndërmarrjes së Ujësjetësimit për drita dhe ujë sepse e ushtron aktivitetin në godinat e Shërbimit Social Shtetëror.

Detyrime për pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore e shëndetësore (llog. 421,435,436) dhe detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa (llog. 431) të muajit Dhjetor të çdo viti të cilat janë likuiduar në muajin Janar të vitit pasardhës.

Ne përfundim vlerësojmë, se nga ky institucion nuk ka detyrime të prapambetura të pa likuiduara ndaj subjekteve të tjera apo ndaj të treta.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse monitorimi i zbatimit të buxhetit është menaxhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë efektive e efçente.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

Hartimi i planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin korrent, dhe për periudhën afatmesëm.

Verifikimi i raportimit periodik të monitorimit të performancës së buxhetit, nga njesitë e qeverisjes qendrore, si dhe përgatitja e informacionit analitik mbi ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Shpenzimet e kryera në fund të çdo muaji janë rakorduar në degën e thesarit. Hartimi dhe raportimi i shpenzimeve të kryera në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është kryer sipas strukturës buxhetore bazuar në të dhënat e evidentuara në ditarin e shpenzimeve.

Realizimi i buxhetit për periudhën e audituar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme :

LLogari a	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
600	7.000.000	6.997.629	7.000.000	6.397.570	7.000.000	5.211.130
601	1.600.000	1.326.664	1.600.000	885.260	1.800.000	1.045.215
602	2.000.000	1.648.529	3.800.000	2.105.630	8.000.000	6.531.076
606	30.000	30.000	30.000	30.000		
Shuma	10.630.000	9.972.822	12.430.000	9.418.460	16.800.000	12.787.421

Siç shikohet dhe nga tabela, plan buxheti për Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve Tiranë është relativisht i vogël.

Për vitin 2016, alokimi i fondeve është kryer nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinisë (Drejtorja e Financës) me shkresën nr. 499/1 prot, datë 29.01.2016.

Për vitin 2017, alokimi i fondeve është kryer nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise (Drejtoria e Financës) me shkresën nr. 7723/1 prot., datë 20.01.2017.

Për vitin 2018, alokimi i fondeve është kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Drejtoria e Financës) me shkresën nr. 5602/4 prot., datë 22.01.2018.

Për vitin 2019 plan buxheti për shpenzimet korrente i dërgohet Shërbimit Social Shëndetësor Tiranë i cili me shkresën nr. 68/35 prot., datë 08.04.2019 ka alokuar fondet përkatëse për Agjencinë Shtetërore të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, Tiranë.

Për këtë sistem nuk ka rezultuar gjelje.

IV.6.Sistemi për funksionimin dhe monitorimin e të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

Objekti i auditimit:

Të vlerësojë nëse janë arritur objektivat e institucionit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me institucione të tjera.

Fushat që u morren në konsideratë:

Hartimi i planeve të punës bazuar në objektivat e institucionit dhe realizimi i tyre.

Përgatitja e informacionit, statistikave dhe raportimi mbi monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë nëpërmjet strukturave të saj pranon, ndjek, plotëson, shqyrton dhe vlerëson administrativisht kërkesat e çdo subjekti që informon për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

E gjithë procedura e veprimeve procedurale evidentohet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkrrese duke iu bashkangjitur praktikës si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjithë procesverbaleve, kujtesave, informacioneve si dhe akteve të vlerësimit lidhur me trajtimin e fëmijëve të mbrojtur.

Po kështu bazuar në Ligjin Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 49, pika ç, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) pjesë e organeve vendore raportojnë pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) periodikisht të dhënat statistikore që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësite administrative përkatëse.

Sipas ligjit të ri Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka një punonjës për mbrojtjen e fëmijës i cili ka për detyrë të identifikojë rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut si dhe të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes.

Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës janë struktura përgjegjëse në nivel vendor që identifikojnë dhe marrin në mbrojtje fëmijët në rrezik. Ato funksionojnë si struktura përgjegjëse pranë bashkisë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, të vendosura në Drejtorinë e Shërbimeve Shoqërore. NJMF ka detyrë të mbështesë punonjësën për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, (PMF) për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Po kështu bazuar në Ligjin Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 49, pika ç, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës raportojnë pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) periodikisht të dhënat statistikore që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësite administrative përkatëse.

Aktualisht në bazë të dhënave të përditësuara, pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe ndryshimeve në reformën territoriale, në të gjitha bashkitë, 61 bashkitë e vendit, janë ngritur dhe funksionojnë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës. Në të gjithë vendin funksionojnë 236 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki dhe njësi administrative.

NJMF në 61 bashkitë e vendit, kanë raportuar për vitin 2018 informacionin e përpunuar për punën e 236 PMF-ve në 61 bashkitë e vendit. Në bazë të raportimeve të tyre, Agjencia Shtetërore e të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Tiranë harton raporte përmbledhëse me të dhënat mbi punën dhe rastet e menaxhuara nga PMF-të gjatë periudhave vjetore.

Cdo sektor i ASHDMF Tiranë ka hartuar objektivat vjetore, planet e punës vjetore dhe 3-mujore të cilat janë miratuar nga Kryetari i saj. Cdo punonjës është njohur me objektivat e punës, ndarjet e punës sipas nivelit të përgjegjësisë dhe për çdo punë të realizuar punonjësit kanë hartuar raporte, analiza, informacione dhe statistika të cilat i janë dërguar titullarit dhe më pas janë raportuar tek MSHMS.

Për të verifikuar gjurmën dokumentuese për punën e kryer u përzgjedh për auditim plani i punës për vitin 2018, raportimet e kryera si dhe statistikat e raportuara për të gjithë rastet e evidentuara.

Nga të dhënat e NJMF-ve rezulton se për vitin 2018 janë menaxhuar 1897 raste në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. 997 janë raste të reja për trajtim, rreth 2 % të totalit, 483 janë femra dhe 514 meshkuj. Kurse 615 janë raste të mbyllura në të cilën fëmijët kanë përfituar trajtimin e duhur.

Vizitat në familje

Gjatë vitit 2018, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në gjithë vendin kanë realizuar **2190 vizita në familje**. Vizitat në familje janë kryer nga NJMF sëbashku me një punonjës social nga drejtoria e shërbimit social në bashki. Në varësi të rastit, NJMF/PMF kanë kërkuar mbështetjen e punonjësve me të specializuar për menaxhimin e rasteve, gjatë kryerjes së vizitës në familje. Në disa raste janë kërkuar ndihma nga punonjësit e policisë kur situata ka paraqitur rrezikshmëri për punonjësin, ose kur ndërhyrja e policisë ka qenë e domosdoshme për zgjidhjen e konflikteve në familje.

Vizitat janë realizuar me qëllim verifikimin e rasteve të referuar nga aktorë të ndryshëm, si ASHDMF, policia, media, OJF. Në këto vizita NJMF ka bërë verifikimin e rastit dhe vlerësimin fillestar. Për rastet kur NJMF-të kanë vendosur masat e mbrojtjes dhe mbikqyrje të specializuar, në familje janë realizuar vizita të shpeshta e të qëllimshme.

Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë raportuar menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës për rastet e dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës të fëmijët.

Bazuar në të dhënat statistikore të ASHDMF Tiranë rezulton që policia ka raportuar numrin më të madh të rasteve, 128 prej tyre ose 12% të rasteve, të ndjekur nga 107 raste raportimi të raportuara nga OJF. Prindërit dhe institucionet arsimore gjithashtu kanë rol aktiv në referimin e rasteve. Institucionet shëndetësore, kanë qënë më pak aktive në identifikimin e tyre.

Një numër i konsiderueshëm rastesh, 131 prej tyre ose 13% të rasteve të raportuara nga totali i rasteve të reja janë referuar nga aktorët e tjerë si mediat, të afërm të fëmijëve, linja Alo 116 111, shërbimi i provës, institucionet rezidenciale. Rritja e numrit të rasteve të raportuara nga aktorët e tjerë joshitetërorë dhe shtetërorë dëshmon për rritjen e sensibilizimit për të raportuar dhe identifikuar fëmijët në nevojë për mbrojtje.

Shumica e rasteve të menaxhuara të raportuara nga NJMF/PMF i përkasin rasteve me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Raste me rrezikshmëri të mesme janë menaxhuar 861 raste ose 45 % e rasteve, kurse raste me rrezik të ulët janë menaxhuar 651 raste ose 34 % të rasteve në total.

Për vitin 2018 janë **349 raste të identifikuar si fëmijë në situatë rruge** në vend ku **286 raste** prej tyre janë në proces menaxhimi. **12 raste** janë identifikuar fëmijë si viktimë trafikimi/viktima të mundshme trafikimi dhe janë marrë në mbrojtje sipas procedurave të reja për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Me qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe heqjen e tyre nga situatat e shfrytëzimit, për **30 fëmijë janë aplikuar masat e mbrojtjes** sipas ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Gjatë trajtimit dhe menaxhimit të rasteve janë dërguar **për procedim penal 12 raste të prindërve** të cilët shfrytëzojnë ekonomikisht fëmijët e tyre.

Të gjitha rastet e raportuara në ASHDMF Tiranë janë me dosje të veçanta, ku kanë bashkangjitur të gjithë dokumentacionin procedural në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Sa më sipër theksojmë së institucioni ka ndjekur të gjithë hapat ligjore për përmbushjen e objektivave të saj duke e pasqyruar çdo angazhim me gjurmët përkatëse të auditimit të cilat pasqyrojnë qartë punën e çdo punonjësi dhe rezultatin e arritur.

Përveç se atyre më sipër u konstatua se kushtet në të cilën punonjësit ushtrojnë detyrat funksionale janë shumë të vështira. Të 7 punonjësit ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një zyrë që nuk është më e madhe se 15m², e cila është zyrë e Shërbimit Social Shtetëror dhe i është dhënë në përdorim ASHDMF Tiranë.

Ky institucion i një rëndësie të veçantë, përveç detyrës dhe përgjegjësisë që ka për monitorimin e zbatimit të të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve kryen edhe programe kualifikuese e trajnuese për edukimin, ndërgjegjshmerinë qytetare si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu ky institucion raporton në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të gjithë statistikave të hartuar mbi bazën e monitorimit si dhe hapat që janë ndjekur për eliminimin e problematikave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Kjo mbingarkesë pune me një axhendë të pasur objektivash, me një numër të vogël punonjësish në strukturë, e ndodhur në kushte jo të përshtatshme pune për shkak të mjedisit tepër të vogël ku angazhohet, mund të çënojë kryerjen e detyrave me efikasitet dhe efektivitet si dhe uljen e performancës në realizimin e objektivave.

Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore të reja të sipërmendura dhe sigurimin e funksionimit normal dhe efektiv të punës në institucion vlerësojmë se është e domosdosme sigurimi i mjediseve të mjaftueshme për zyra dhe për akomodimin e stafit.

IV.7. Të tjera

- Probleme të ndryshme të konstatuara gjatë punës në terren.

Gjatë punës në terren nuk u konstatuan **gjetje të tjera**.

IV.8. Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Mjedisi i kontrollit- Agjencia Shtetërore e të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Tiranë ka për mision të monitorojë zbatimin e Ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

Referuar gjetjeve të konstatuara vlerësojmë se stafi i ngarkuar me detyra që lidhen me prokurimet, menaxhimin e aktiveve dhe mbikqyrjen e kontratave ka qenë në nivelin e duhur për njohjen e akteve që operojnë në këto fusha. Pavarësisht se këto duken si procese rutinë vërehet se kanë nxitur nivelet menaxhuese në drejtim të kërkesës së llogarisë në përmbushje të detyrave në përputhje me aktet ligjore. Nuk ka neglizhenca që tregojnë mospërmbushje të detyrave nga grupet e punës për fushën e prokurimeve, burimeve njerëzore dhe pagat.

Nivelet e menaxhimit duhet të forcojnë qëndrimin e tyre mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm duke rritur kërkesën e llogarisë dhe të mbështesë grupet e punës për çdo problematikë që mund të haset gjatë punës.

Menaxhimi i riskut-, ASHDMF Tiranë nuk ka hartuar regjistrin e riskut. Ky komponent është mjaft i rëndësishëm pasi bazuar në objektivat e vendosura, institucioni do të vlerësojë risqet e mundshme si dhe do të propozojë marrjen e masave të duhura për strukturat përgjegjëse.

Për këtë rekomandohet të bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin e regjistrit të riskut në mënyrë të tillë që ky dokument të përmbajë të gjithë komponentët e tij.

Gjithashtu ky regjistër duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Aktivitetet e kontrollit- Nga ana e titullarit të institucionit për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë ngritur grupe pune për mbikqyrje dhe zbatimin e kontratës. Kontrollat e ngritura kanë funksionuar siç duhet pasi në përmbushje të detyrave të caktuara kanë vepruar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Grupet e punës të ngritura për përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike apo dhe njësia e prokurimit kanë dhënë siguri në përmbushje të akteve ligjore që operojnë në fushën e prokurimeve, duke shmangur në punën e tyre evidentimin në dokumentacionin e mbajtur të argumenteve dhe analizave si nga ana teknike ashtu dhe ligjore.

Kontrollet menaxhuese nuk kanë qenë në nivelin e duhur për sitemin e kontabilitetit dhe shpenzimet e transportit për lëvizjet brenda vendit punonjësit e institucionit nuk kanë patur njohuri të thelluara për bazën ligjore që operon në këto fusha.

Informacioni dhe komunikimi- Ky komponent nuk është kuptuar si shkëmbim i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjithë niveleve si horizontalisht dhe vertikalisht. Informacioni nuk ka shërbyer në mbështetje të funksionimit të kontrolleve të brendshme, kjo është reflektuar në mungesën e këtyre kontrolleve.

Monitorimi- Nisur nga gjetjet e konstatuara nga auditimit, vlerësojmë se ka munguar monitorimi sipas hierarkisë, nga menaxheret e nivelit më të ulët përgjegjës sektori e deri te menaxherët e nivelit më të lartë drejtor ekzekutiv (kryetari).

Mungesa e monitorimit të aktiviteteve nuk ka garantuar se punonjësiti i zbatonjë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet dhe aktivitete të kontrollit po funksionojnë siç duhet për kontabilitetin dhe pagesat.

V. Rekomandimet.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në germën "c" të nenit 6, dhe germën "e" të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", për arritjen e objektivave të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat

dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë, si dhe për të rritur efektivitetin në punën, funksionimin dhe drejtimin e këtij institucioni, **rekomandojmë:**

1. Rekomandojmë të hartohet regjistri kontabël, i aktiveve si dhe të bëhet regjistrimi i të gjitha ngjarjeve ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga Nëpunësi Zbatues të ushtrohen kontrollet e brendshme të domosdoshme për mirëfunksionimin e sistemit kontabël e financiar.

Afati: Menjëherë.

2.Rekomandojmë që Nëpunësi Autorizues i këtij institucioni të nxjerë urdhër të brendshëm për të ngarkuar një specialist me detyrën e magazinës krahas detyrave që ka të përshkruar në rregulloren e punës bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 15.

Afati: Menjëherë.

3. Rekomandojmë që nga specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) të hartohet gjurma e auditit për vlerën 454.298 lekë, lëvizje brenda sistemit në llogarin 218 të evidentuar si shtesë e paraqitur në bilancin e vitit 2017.

Afati: Menjëherë.

4. Rekomandojmë që specialistia e Sektorit të Koordinimit dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë) brenda muajit Korrik të vitit 2019 të plotësoje dokumentacionin vërtetues shoqërues mbi lëvizjen e aktivitetit (kondicioner) si pakësim paraqitur në llogarin 214 të bilancit për vitin 2017, procedura bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, në të kundërt vlera 99.600 lekë të derdhet në buxhetin e shtetit.

Afati: Menjëherë.

5.Rekomandojmë që komisioni i ngritur me urdhër të drejtorit për inventarizimin e asetëve të institucionit të kryejë me përgjegjësi ligjore të gjithë procedurën për inventarizimin sipas urdhrave të titullarit të njësisë për të vërtetuar saktësinë dhe cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve.

Afati: Menjëherë

6. Të hartohet regjistri i riskut i institucionit i cili duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Afati: Menjëherë.

7. Për çdo shërbim jashtë vendit të merret autorizim i titullarit të institucionit qendror nga i cili varet njëzia shpenzuese,ose të deleguarit të tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Afati: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

8. Elona Halilosmani të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën 340 lekë të përfituar për shërbimin Taksi, për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Afati: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9. Ina Verzivolli të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën **14,080** lekë të përfituar për shërbimin Taksi.për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Afati: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

10. Anila Bregu të arkëtojë në buxhetin e shtetit shumën **1,070** lekë të përfituar për shërbimin Taksi.për lëvizje brenda Tiranës, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Afati: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11. Titullari i institucionit përgjegjës për vitin 2017 (znj. Ina Verzivolli), e cili ka nxjerrë urdhër të brendshëm për organizimin e takimit të punës ne Durrës (drekë pune) në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sëbashku me pjesëmarrësit në drekën e organizuar, do të kthejnë në buxhetin e shtetit, në përpjestim të drejtë me numrin e pjesëmarrësve, shumën prej **38,100** lekë.

Afati: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ky Projekt Raport hartohet në dy kopje, të cilat i dorëzohen subjektit të audituar dhe i lihen në dispozicion 10 ditë pune nga data e dorëzimit të tij, për t'u analizuar e nënshkruar me ose pa kundërshtime.

Pas nënshkrimit, një kopje dërgohet në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë.

Për ASHDMF Tiranë

Alma Tandili, Kryetare e ASHDMF

Ina Verzivolli, ish Kryetare e ASHDMF

Rabushe Kalemasi, Specialiste e Sektorit të Koordinimit
dhe Statistikës (e ngarkuar për mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë).

Grupi i auditimit

Jorgji Qeramixhi

Zogulla Koto

